



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2024:074744

Datë: 04.10.2024

Numri i dokumentit: 06252988

PPP.nr.04/2024

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Dega në Kaçanik, si gjykatë përmbartimore e shkallës së parë, gjyqtari Riza Livoreka, si gjyqtar përmbartues, me sekretaren juridike Azemine Berisha, duke vendosur në çështjen përmbartimore të Kreditorit N. V. , B. V. S. V. dhe S. V. 1, të gjithë nga Hani i Elezit, të cilit me autorizim i përfaqëson Avokati V. M. , rruga “Brigada”161” lokali D 50 Ferizaj, kundër D. M. (F.) V., F. (A.) V. dhe R.(F.) V., rruga “...”, numër 63, Hani i Elezit, duke vendosur lidhur me Prapësimin e Debitorëve, jashtë seancës gjyqësore me datë 04.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.REFUZHET Prapësimi i debitorve R. V. dhe M. V., nga Hani i Elezit , i ushtruar më datën 04.12.2023, kundër Urdhrit Përmbartues P nr.585/23, i datës 21.11.2023 në tërësi **SI I PABAZUAR**

II.DETYROHET, debitori që kreditorit të i'a paguajë shumën sipas propozimit për përmbartim dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, të cilat do të llogariten nga përmbartuesi privat, të gjitha këto pagesa do të bëhet në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit në dorëzim të këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

, Kreditorët N. V. , B. V. S. V. dhe S. V. 1, të gjithë nga Hani i Elezit, më datë 17.11.2023, tek përmbarusi privat G. H M. , me seli në Ferizaj, e kanë dorëzuar propozimin për përmbarim kundër D. M. (F.) V., F. (A.) V. dhe R. (F.) V., rruga "...", numër 63, Hani i Elezit.

Me këtë propozim ka kërkuar që të caktohet përmbarimi dhe të detyrohen debitorët qe kreditorve N. V. , B. V. S. V. dhe S. V. 1, të gjithë nga Hani i Elezit, që t'ia kompensoj shumën prej 3,786.00€. Po ashtu me këtë propozim ka kërkuar që të paguhen edhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Përmbaruesi Privat me datën 21.11.2023, e ka lejuar përmbarimin me urdhër P.nr 585/2023 dhe me këtë urdhër janë udhëzuar debitorët që në afat prej 7 ditësh të paraqes prapësim në propozimin për përmbarim. Përmbaruesi privat më datën 27.11.2023, debitorëve ja ka dorëzuar propozimin për përmbarim së bashku me provat.

Debitorët R. V. dhe M. V. nga Hani i Elezit, në afatin e paraparë ligjorë kanë paraqitur Prapësim, me të cilin i ka propozuar gjykatës që të nxjerr aktvendim me të cilin aprovet prapësimi i debitorit dhe ta anuloj gjykata urdhrin përmbarimor P.nr.585/2023, i datës 21.11.2023.

Përmbaruesi një kopje të prapësimit të debitorit së bashku me njoftimin për të drejtën e paraqitjes së prapësimit i'a ka dorëzuar të autorizuarit të kreditorëve me 10.1.2021, i cili në afatin e parapare ligjorë ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata e refuzoi prapësimin e debitorëve si të pa bazuar, për arsyeje se debitorët prapësimin nuk e ka mbështetur në provat, asnjë provë nuk ja ka bashkangjitur prapësimin siç është paraparë me nenin 69 par. 4 të LPP-së, si dhe nuk ka paraqitur asnjë nga shkaqet e parapara me nenin 71 nga pika 1.1 deri tek pika 1.12 të LPP-së.

Kreditori propozimin për përmbarim e ka mbështetur në dokumentin përmbarimor-vendim të gjykatës , i cili është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm.

Gjykata i analizoi pretendimet e kreditorëve , të cilit kanë kërkuar qe propozimi për përmbarim të aprovohet, ndërsa prapësimi i debitorit të refuzohet, këtyre theksimeve gjykata u dha besimin dhe e refuzoi si të pa bazuar prapësimin e debitorëve.

Gjykata i analizoi pretendimet e debitorëve, të paraqitura në prapësim, mirëpo këto pretendime nuk kishin ndikim që të vendosej ndryshe, sepse propozimi është bërë duke u bazuar në dokumentin përmbarimor-vendimin e Gjykatës së shkallës së parë, i cili është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm.

Gjykata i detyroi debitorët qe kreditorëve të ua paguajna edhe shpenzimet e procedurës përmbarimore të cilat do të llogariten nga përmbaruesi privat, konform nenit 13, par.4 të LPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,

Dega në Kaçanik

PPP.nr.04/2024 prej datës 04.10.2024

Gjyqtari,
Riza Livoreka

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh ,nga dita e pranimit, ankesa i parashtrohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

Dërguar me datën 04.10.2024

Të autorizuarit të kreditorëve 1x1

Debitorëve 2x1